

VENDIM
Nr.608, datë 6.5.2009

PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE “VITRINA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2,43, 44 e 45 të ligjit nr. 9741, datë 21.5. 2007 “Për arsimin e lartë në Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e shkollës së lartë private “Vitrina”, e cila do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Shkolla e lartë private “Vitrina” do të organizohet në katër fakultete:

a) Fakulteti Shkencave Politike, me programet e studimit, në formën e studimeve me kohë të plotë, “Shkenca politike” dhe “Marrëdhënie ndërkombëtare”.

b) Fakulteti i Drejtësisë, me programin e studimit, në formën e studimit me kohë të plotë “Drejtësi”.

c) Fakulteti Ekonomi-Turizëm, me programet e studimit, në formën e studimit me kohë të plotë “Financë- Bankë”, “Menaxhim biznesi” dhe “Menaxhim turizmi”.

ç) Fakulteti i Inxhinierisë, me programet e studimit, në formën e studimeve me kohë të plotë “Inxhinieri informatike”.

3. Shkolla e lartë private “Vitrina” do të ofrojë programet e studimeve të ciklit të parë, të cilat do të zgjasin 3 vjet dhe, në mbarim të tyre, do të lëshojë diplomë të nivelit të parë (DNP), përkatësisht në:

a) Shkenca politike;

b) Marrëdhënie ndërkombëtare;

c) Drejtësi;

ç) Financë-bankë;

d) Menaxhim biznesi;

dh) Menaxhim turizmi;

e) Inxhinieri elektronike;

ë) Inxhinieri informatike.

4. Ngarkohet shkolla e lartë private “Vitrina” që, për çdo program studimi, të sigurojë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

5. Shkolla e lartë “Vitrina” do ta fillojë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të ketë marrë, jo më vonë se tri javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij, për këtë qëllim.

6. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

7. Shkolla e lartë private “Vitrina” duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

8. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha